

Një ajet paralajmërues për udhëheqës dhe dijetarë

Tefsir et-Taberi

Në një pjesë, sureja el-Ma'ideh kritikon një sërë vetish të çifutëve, pastaj thotë:

“Përse *rabbaniyyunët* dhe *ahbarët* nuk i ndaluan nga e folura e tyre mëkatore dhe nga marrja e ryshfetit (*suht*).” (el-Ma'ideh, 63)

Në shpjegim të këtij ajeti, interpretuesi i madh i Kuranit, Ebu Xha'fer Muhamed ibn Xherir et-Taberi, shkroi:

“Allahu sikur po thotë: Përse këta nuk i ndalonin njerëzit që ngarendin të bënin gjynahe dhe zullum, si dhe pushtetarët që merrnin ryshfet? Përse çifutët bënë këtë? *Rabbaniyyun* këtu janë urdhëruesit e tyre, udhëheqësit politik dhe ekspertët e çështjeve politike; ndërsa *ahbarët* janë dijetarët fetarë dhe shembujt në moral. Pra, përse këta nuk i ndalonin nga të folurit mëkatar, që është rrena dhe gjërat mashtruese. Kjo ndodhi, sepse vendimet që këta udhëheqës morën për popullin e tyre, nuk qenë në përputhje me vendimet e Allahut; ata shkruan shkresa me duart e tyre dhe thanë: ‘Ky vendim është nga Allahu. Kjo është pjesë e Librit të Tij.’ Allahu ﷻ thotë:

‘Mjerë ata për atë çfarë shkruan duart e tyre! Dhe mjerë ata për atë që fituan nga kjo!’ (el-Bekare, 79)

Për sa i përket thënies së Allahut “...dhe nga marrja e ryshfetit (*suht*)”, kjo ka të bëjë me ryshfetin që këta udhëheqës merrnin për nxjerrjen e vendimeve që kundërshtonin Librin e Allahut ﷻ. Dhe ne më herët kemi shpjeguar me prova domethënien e fjalëve *rabbaniyyun*, *ahbar* dhe *suht*, kështu që s'ka nevojë të përsëritet.

‘Sa e keqe është ajo çfarë bënë!’

Kjo është një nga betimet që bën Allahu ﷻ. Allahu sikur po thotë: Betohem se i keq është ky veprim i tyri! Pra, e keqe ishte lënia e detyrës nga ana e udhëheqësve dhe e dijetarëve për ndalimin e atyre që ngarendin të bënin gjynahe dhe merrnin ryshfet!

Dijetarët kanë thënë se në tërë Kuranin s'ka ajet që qorton dijetarët më rreptë sesa ky ajet dhe as ndonjë ajet më frikësues për ta sesa ky.

Për sa i përket thënies së Allahut ‘Përse *rabbaniyyunët* dhe *ahbarët* nuk i ndalonin nga e folura e tyre mëkatore dhe nga marrja e ryshfetit (*suht*)’, ed-Dahhak ibn Muzaahim tha: ‘S'ka asnjë ajet në Kuran që më frikëson më shumë lidhur me mosreagimin tim ndaj së keqes sesa ky!’

Ibn Abbas tha: ‘S'ka asnjë ajet në Kuran më të rreptë në qortim sesa ky: ‘Përse *rabbaniyyunët* dhe *ahbarët* nuk i ndalonin nga e folura e tyre mëkatore dhe nga marrja e ryshfetit (*suht*).’

Interpretuesit e Kuranit shpjeguan këtë ajet në mënyrën që u shpjegua më lart. Ja çfarë kishin për të thënë ata:

“... ed-Dahhak tha: ‘*Rabbanijunët* dhe *ahbarët* janë ekspertët në ligjin fetar të tyre, janë recituesit (e Librit të tyre) dhe dijetarët e tyre.’

Transmetuesi tjetër tha: ‘Pastaj ed-Dahhak tha: ‘S’ka asgjë që më frikëson më shumë sesa ky ajet!’

Lidhur me domethënien e këtij ajeti, Ibn Abbas tha se kjo nënkupton: ‘Sa e keqe është ajo çfarë bënë *rabbanijunët!*’” (*Tefsir et-Taberi* 10/448-450)

Në shpjegimin e po të njëjtit ajet, el-Hafidh ibn Kethir po ashtu përcjell nga Ibn Xherir et-Taberi disa nga qëndrimet lidhur me frikën që ky ajet ngjallte te disa dijetarë të selefëve, pastaj shton transmetimin vijues:

‘Jahja ibn Ja’mur tha: ‘Ali ibn ebi Talib mbajti një fjalim ku lartësoi e lavdëroi Allahun dhe tha:

‘O njerëz! Ajo që shkatërroi popujt para jush qe fakti se ata bënë gjynahe ndërsa *rabbanijunët* (urdhëruesit e tyre, udhëheqësit politik) dhe *ahbarët* (dijetarët fetarë dhe shembujt në moral) nuk i ndalonin nga kjo. Pasi kaluan kufijtë në mosbindje dhe *rabbanijunët* e *ahbarët* as nuk u përpoqën t’i ndalonin, u kapën me ndëshkime. Pra, urdhëroni për mirë dhe ndaloni nga e keqja para se t’ju vijë edhe juve e ngjashmja me atë që u ndodhi atyre! Dhe ta dinin se urdhërimi për mirë dhe ndalimin nga e keqja nuk ndërpresin furnizimin tuaj e as nuk shkurton jetëgjatësinë.’” (*Tefsir ibn Kethir* 3/144-145)